



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 81/10

Prishtinë, më 28.04.2010, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Gani Koci, Naser Osmani, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Armend Zemaj, Besa Gaxheri, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj, Mufera Sinik dhe Suzana Novobërdaliu.

Mungoi: Hajdin Abazi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Agim Krasniqi Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MEF, Ali Hamiti Kryetar i ZRRE-së, Sokol Haziri Komisioner i Ndihmës Juridike, Mehdi Geci Kryetar i KPM-së, Ismet Krasniqi Sekretar i Kuvendit të Republikës së Kosovës Teki Shala dhe Ramadan Islami nga GTZ, monitorues nga Zyra e presidentit, OSBE, NDI, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasha Prica Tisma, Vilson Ukaj dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

**Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2009**  
**I ftuar : Ali Hamiti, Kryesues i Bordit të ZRRE-së;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2009**  
**I ftuari : Sokol Haziri, Komisioner i Ndihmës Juridike;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009. I ftuari : Mehdi Geci , Kryetar i KPM-së**
- 5. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009,**  
**I ftuar : Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**

6. Shqyrtimi i propozim-amendamentit të grupit punues të Komisionit për Buxhet e Financa për Projektligjin për Financimin e Subjekteve Politike;
7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryesuesi** lidhur me amendamentin 47 të komisionit funksional për projektligjin për pagat e shërbyesve civil, njoftoi se iu ka drejtuar MEF-it për të bërë vlerësimin e kostos buxhetore që shkakton ky amendament. Përgjigjen e kemi marrë dhe nga ajo shifet se aprovimi i këtij amendamenti shkakton kosto të lartë buxhetore, gjë që është edhe në kundërshtim edhe me politikat e FMN-së dhe mosrespektimi i tyre mund të shkakton edhe humbjen e donacioneve nga jashtë. Prandaj duke vlerësuar rëndësinë e rishqyrtimit të vendimit të komisionit lidhur me këtë amendament, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë të re - Rishqyrtimi i amendamentit 47 të komisionit funksional lidhur me projektligjin për pagat e nëpunësve civil.

**Besa Gaxherri** theksoi se nuk e përkrah propozimin, pasi që Komisioni ka përfunduar shqyrtimin e projektligjit për pagat e nëpunësve civil dhe amendamentet e komisionit funksional dhe ka nxjerr rekomandimin për Kuvendin. Çdo përpjekje për ta rishqyrtuar edhe njëherë këtë çështje, është shkelje e rregullave procedurale dhe Rregullores së punës së Kuvendit.

**Naser Osmani** tërhoqi vëmendjen se për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore që përmban amendamenti, mund të mos kalojë as ligji fare. Prandaj është e nevojshme që Komisioni të rishikojë edhe njëherë vendimin e vet lidhur me amendamentin 47.

Pas propozimeve dhe vërejtjeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me gjashtë vota Për (z. Gani Koci, z. Naser Osmani, znj. Kosara Nikolić, znj. Safete Hadërgjonaj, znj. Myrvete Pantina, dhe z. Armend Zemaj) tri Kundër (znj. Besa Gaxherri, znj. Suzana Novobërdaliu dhe z. Xhevdet Neziraj) dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Shtohet pika e re - Rishqyrtimi i amendamentit 47 të komisionit funksional lidhur me projektligjin për pagat e nëpunësve civil dhe do të jetë pika e dytë e rendit të ditës. Ndërsa në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

### 2. Rishqyrtimi i amendamentit 47 të komisionit funksional lidhur me Projektligjin për Pagat e Nëpunësve Civil

**Kryesuesi** lidhur me çështjen në fjalë, theksoi se nuk duhet të vijmë me qëndrime individuale dhe të ndikuar politikisht, por të flasim duke mbrojtur interesin e përgjithshëm.

**Xhevdet Neziraj** theksoi se ministrat duhet të jenë më përgjegjës në deklaratat e tyre para mediave për rritjen e pagave dhe përmisimin e kushteve të nëpunësve. Ata paraprakisht duhet të dinë buxhetin e tyre para se të bëjnë deklaratat dhe marrëveshjet të këtilla. Për shkak të këtij parimi jam kundër.

**Agim Krasniqi** njoftoi në bazë të kërkesës së kryetarit të këtij komisioni, MEF-i ka analizuar amendamentin 47 në kontekst të kostos buxhetore të tij, dhe ka vlerësuar se miratimi i tij sjell efekte negative të dyfishta për buxhetin e Kosovës. Efekti i parë ka të bëjë me atë se miratimi i tij, buxhetit të Kosovës do ti kushtojë mbi 30 mili € kosto shtesë. Efekti i dytë negativ ka të bëjë me atë se në mënyrë zinxhirore do të sjell reaksione të punëtorët e sektorëve tjerë, pavarësisht që nuk janë rregulluar me këtë ligj. Sugjerimet e MEF-it janë që komisioni të rishqyrtojë vendimin e marrur dhe Kuvendi të miratoj ligjin që mund të jetë i implementuar financiarisht, duke respektuar edhe kërkesat e FMN-së.

**Kryesuesi** në buxhetin për vitin 2010 është paraparë rritja e pagave për shërbyesit civil deri 20% dhe në mungesë të ligjeve nuk ka mundur të implementohet. Është çështje e punëdhënësit dhe punëmarrësit që të rregullojnë çështjen e kompensimeve. Nëse amendamenti aprovohet ligji nuk mund të zbatohet ligji apo do të shkaktoj reaksione të punëtorëve tjerë shtetëror.

**Armend Zemaj** propozimi i këtij amendamenti dhe deklaratat që bëhen lidhur me këto çështje, tregojnë orientimin e tyre në politika të majta. Sa i përket kompenzimeve për shujta dhe kompenzimeve tjera, këso benificione nuk i kanë as në vendet më të zhvilluara dhe sociale. Amendamenti i propozuar nga komisioni funksional nuk është i menduar mirë. Jam për përmissimin e kushteve të punëtorëve të administratës publike por jo në këtë formë. E kundërshtoj aprovimin e këtij amendamenti, pasi që Kosova duhet të orientohet në politika zhvillimore dhe jo në shtet social.

**Myrvete Pantina** arsyetoi pse ka votuar për mos fshirjen e amendamentit 47, për shkak të pagave të ulta të shërbyesve civil, që mendojë se ky ka qenë edhe qëllimi i komisionit funksional, përkitazi me këtë amendament. Sikur të ndodhte rritja e 20%, nuk do të kishte arsye për kompenzime dhe shujta.

**Safete Hadërgjonaj** theksoi se pajtohet me konstatimet e z. Zemaj se të gjitha ata që janë për politika të djathta, këtu në komisionin për interesa personale dhe partiake ngrisin zërin për çështjet që nuk është e nevojshme të diskutohen. Ligjet duhet ti bëjmë konform rregullave ligjore të vendit, të rajonit dhe standardeve të BE-së. Dëshirojmë që parasegjithash anëtarët e këtij komisioni, ti marrin me seriozitet rekomandimet e FMN-së. Rritje të pagave ka pasur edhe përpara. Edhe me këtë ligj do të ketë rritje të pagave, dhe nuk ka nevojë që këto çështje të shëndrrohet në çështje politike, sociale apo problem të sindikatave, kur është e kuptueshme për ne si anëtarë të komisionit.

**Kosara Nikolić** njoftoi se për këtë çështje e kam njoftuar kryetarin se nuk kam kuptuar kur është votuar në mbledhjen e fundit dhe si rezultat nuk jam deklaruar. Pasi kam kuptuar se është fjala për amendamentin 47, mendojë se për shkak të implikimeve buxhetore rrezikon të mos implementohet as ligji dhe nuk duhet kalojë. I dijmë edhe presionet e FMN-së. Nëse rriten pagat e parapara me këtë ligj, nuk do të ketë nevojë për shtesa dhe kompenzime tjera.

**Suzana Novobërdaliu** njoftoi se si grup parlamentar për këtë çështje nuk kemi qëndrim në komision, do të deklarohemi në seancë dhe si rezultat unë do të abstenoj.

**Xhevdet Neziraj** duke u ndërlidhur me diskutimet e z. Zemaj dhe znj. Hadërgjonaj, thekoi se u them atyre, që në grupet parlamentare ku i keni edhe ministrat, t'iu tregoni partive të juaja se janë të djathta, ndërsa subjekti im (IRDK), ka orientime të majta politike.

Pas propozimit dhe vërejtjeve, Komisioni me gjashtë vota Për (z. Gani Koci, z. Naser Osmani, znj. Kosara Nikolić, znj. Safete Hadërgjonaj, znj. Myrvete Pantina, dhe z. Armend Zemaj), një Kundër (z. Xhevdet Neziraj) dhe një Abstenim (znj. Suzana Novobërdaliu) nxori këtë:

## REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk përkrahu amendamentin 46 që i referohet nenit 23 paragrafit 1.4. të komisionit funksional, sepse i njëjti përmban implikime buxhetore shtesë dhe i rekomandon Kuvendi të mos miratojë atë.

### 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2009

**Ali Hamiti** njoftoi se arsyeja e realizimit të ulët të buxhetit është si rezultat i përfitimit të donacioneve për dy projekte në kategorinë mallra dhe shërbime - “shërbimet për konsulencë”. Pasi që mjete që inkasojmë nga taksat nuk mund të barten në vitin vijues, i kemi ulur ato nën nivelin që e parasheh ligji, meqenëse kemi pasur të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve

**Myrvete Pantina** vlerësoi raportin të përgatitur mirë, i cili është i pasur me të dhëna. Megjithatë bëri vërejtje për shpenzimin e ulët të buxhetit, duke përfshirë edhe shpenzimet kapitale dhe kërkoi sqarim për këtë nivel të ulët të shpenzimeve. Po ashtu kërkoi sqarime për shpenzimet “shërbimet tjera kontaktuese”.

**Armend Zemaj** pyeti a po vazhdoni edhe këtë vit të qëndroni në objekt me qira?

**Kryesuesi** pse nuk janë përfshirë kompanitë e mëdha në faturim, sa vlerësohet mund të jetë borqi tyre. Çështja e dytë ka bërë me konsumatorët e priverligjuar që sipas ligjit çdo vit duhet rishikuar, pyeti a është bërë rishikimi i listave nëse jo, kur do të bëhet kjo?. Problemi ka të bëjë me kompanitë e mëdha siç është “Feronikeli” që shpenzojnë shumë rrymë edhe pse në këtë drejtim janë nënshkruar kontratat jo të favorshme, këto kompani prapë kanë borqe të mëdha.

**Ali Hamiti** sa i përket pyetjeve për mos faturimin e ndërmarrjeve, njoftoi se këto ndërmarrjeve kanë statusin e veçantë dhe nuk i raportojnë ZRRE-së. Kontratat janë të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet në mes ofruesit dhe blerësit të shërbimeve. Uzancat e kontratave janë aq të forta sa që nuk mund të sfidohen as në Gjykatën e Arbitrazhit. Në bazë të ligjit ne kontrollojmë vetëm kushtet teknike të licencës, që kanë të bëjnë me legjitimitetin e kompanisë. Shërbimet tjera kontraktuese janë shërbimet e përkthimi, pasi që nuk kemi përkthyes të punësuar. Sa i përket shpenzimeve kapitale ka ndodhur që për një projekt ka filluar dhe është përsëritur procedura e prokurimit dy herë dhe nuk është realizuar në tërësi projekti, dhe si rezultat është planifikuar të realizohet këtë vit. Ndërsa për qëndrimin në objekt me qira, jemi të interesuar, por kemi marrë përgjigje nga qeveria se në objektin e ri nuk jemi agjencion prioritar për tu vendosur.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit që në seancën plenare, të miratojë Raportin financiar të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009.

### 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2009

**Kryesuesi** është hera e parë e raportimit të këtij komisioni në Komisionin për Buxhet dhe Financa një vërejtje për mosdorëzimin e pasqyrave financiare në MEF, ashtu siç kërkohet me Ligjin për menaxhimi e financave publike.

**Sokol Haziri** është hera e tretë që raportojnë në Kuvend ndërsa hera e parë në këtë komision. I kemi ushtruar funksionet tona, më përjashtim të lëmisë penale për shkak se buxheti mbetet në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Për të përfutur ndihmën juridike, kriter kryesor janë kategoritë sociale, por edhe kategoritë tjera të ngjashme. Buxheti është më i vogël se i vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, që hyjnë edhe shërbimet juridike përmes avokatëve. Objektet i kemi me qira. Me ndihmën e UNDP-se kemi përfutur mbështetjen financiare për hapjen edhe të pesë zyrave tjera.

**Kryesuesi** duke pasur parasysh faktin se ndihma juridike është kategori kushtetuese, pyeti a keni menduar që të ndërmerrni iniciativën për të bërë ligjin e ri, që natyrisht do të rregullohej edhe pjesa e buxhetit dhe raportimit, që do të eliminonte pengesa në punën tuaj.

**Armend Zemaj** pyeti a keni kontaktuar me kuvendet komunale apo me gjykatat e qarkut që në kuadër të tyre ti keni zyret atje? Pastaj pyeti sa keni shpenzuar në krijimin e opinionit më të mirë në aspekt të marketingut por edhe mbajtjes së debateve me qytetar, që opinionit t'iu njohin me detyrat dhe përgjegjësit e juaja, se ku mund t'iu drejtohen dhe qfarë ndihme mund të kërkojnë nga ju?

**Sokol Haziri** në bashkëpunim me Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi është ndërmarrë initiative për bërjen e ligjit të ri. Arsyeja e mosdërmimit të pasqyrave financiare për shkak se zyrtari financiar ka lëshuar vendin e punës. Jemi angazhuar që të zyrtarët tonë të kenë qasje në gjykatat e qarkut dhe të kemi hapësira, por nuk kemi hasur në mirëkuptim. Kemi mbajtur dy prezantimi televizive për sensibilizimin e opinionit, por duke qenë të kufizuar me buxhet jemi kufizuar të punojmë në këtë drejtim.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **REKOMANDIM**

- I. I rekomandon Kuvendit që në seancën plenare, të miratojë Raportin financiar të Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2009.

### **5. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009**

**Mehdi Geci** njoftoi se buxheti i shpenzuar është 89.54%. Arsyeja e mosshpenzimit të një pjese të buxhetit për paga dhe meditje, për shkak të mungesës të një pjese të anëtarëve të Këshillit dhe punëtorëve të administratës, e të cilët nuk janë rekrutuar në mungesë të zyreve për punë. Me qëllim të marrjes së eksperiencave kemi realizuar dy vizita zyrtare në Shqipëri dhe një vizitë në Maqedoni.

**Kryesuesi** pyeti për natyrën e shpenzimit të udhëtimit zyrtar, si dhe një pyetje tjetër se a keni ndonjë akt normativ që rregullon shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile. Shpenzimet për dreka të rishikohen në të ardhmen, pasi që krahasuar me shfrytëzuesit tjerë janë të larta.

**Besa Gaxherri** kërkoi sqarime për disa shpenzime që i vlerësoi të shumta, si për shpenzimet për telefon fiks dhe mobil, për dreka zyrtare, për servisimin e automjeteve. Ndërsa theksoi se është dashur që shpenzimet të orientohen më shumë për trajnime. Në fund pyeti sa është numri i Këshillit dhe punëtorëve të administratës?

**Armend Zemaj** sa i përket shumës për shpenzime për dreka në kompaninë “Shqiponja”, pyeti a është fjala për një drekë apo në vazhdimësi? Shpenzimet duhet orientuar në trajnime, që të rriten kapacitetet për punë, kur dihet që po shtohet vëllimi i punëve të këtij Këshilli, si rezultat i ankesave.

**Shkumbin Demaliaj** vlerësoi se për zyrtarët e lartë dhe të zgjedhur nuk kanë nevojë për trajnime, ata duhet të jenë të përgatitur për punën që duhet të bëjnë dhe trajnimet duhet orientuar për stafin tjetër. Bëri vërejtje për shpenzimi e larta për larjen e veturave. Theksoi se është kundër raportit dhe paraqitjes së kryesuesit të KPMK-së.

**Suzana Novobërdaliu** duke parë shumat e larta për shpenzimet telefonike mobile, pyeti a keni analizuar ofertat e kompanisë ipko, që ofrojnë kushte më të lira në komunikim në një grup personash, në mënyrë që të kursehen këto shpenzimet?

**Safete Hadërgjonaj** vlerësoi raportin mirë të përgatitur, me shpenzime të detalizuara. Sa i përket çështje së trajnimeve ato janë të nevojshme të bëhen vazhdimësi. Më pas pyeti qfarë është shpenzimi për “sigurimin shëndetësor”.

**Mehdi Geci** në asnjë vijë buxhetore nuk kemi pasur tejkalim të shpenzimeve, me përjashtim të servisimit të automjeteve dhe kjo si pasojë asaj se kemi marrur tri vetura nga Ministria për Administratë Publike me defekte të shumta dhe jemi detyruar ti riparojmë. Secili anëtarë i Këshillit ka të drejtën e mjeteve për reprezentacion. Sa i përket drekave në lokalin “Shqiponja” aty janë përfshirë të gjitha drekat që i kemi shpenzuar në kontinuitet. Për shpenzime të telefonisë me vendim është paraparë që kryetari të ketë 90€ në muaj, ndërsa anëtarët 70€. Sigurimi shëndetësor është bërë pas ftesës nga institucionet Zviceriane për një vizitë atje.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **REKOMANDIM**

- I. I rekomandon Kuvendit që në seancën plenare, të miratojë Raportin financiar e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009.

## **6. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009**

**Kryesuesi** raporti më i detalizuar se sa i organizatave tjera buxhetore.

**Ismet Krasniqi** me kërkesën e anëtarëve u fokusua në sqarimin e nivelit të shpenzimeve kapitale, duke krahasuar me ato të planifikuara. Sa i përket investimeve kapitale kemi disa situata që e përcjellin Kuvendi që një kohë të gjatë, siq është rast i mos zgjidhjes së problemit me projektin “Villa Gërmija”. Realizimi i buxhetit për shpenzime kapitale, duke mos llogaritur këtë projekt është rreth 60%. Kjo ngecje ka ndodhur si rezultat i mosrealizimit të tenderëve dhe bartjes së tre projekteve në këtë vit. Më pas përmendi investimet kapitale që janë realizuar vitin e kaluar dhe koston e tyre që janë të prezantuar në raport. Ndër të tjera njoftoi se kemi pasur zotuar mjete për të blerë 13 vetura për kryetarët e komisioneve, por kur është vlerësuar se duhen edhe 13 shofer shtesë është vendosur të blihen vetëm tre vetura “gjipa” për nevoja të komisioneve.

**Besa Gaxherri** vlerësoi raportin gjithëpërfshirës. Megjithatë u interesua të dinte për vendimin për të blerë 13 vetura kryetarëve të komisioneve, dhe vendimin për të ndryshuar këtë dhe për të blerë tre

gjipa, do të ishte mirë ta shohim këto vendime dhe të njihemi se kush e ka marrë dhe kush i shfrytëzon këto vetura?

**Safete Hadërgjonaj** vlerësoi raportin të detalizuar. Do të doja që mënyra e shpenzimit të buxhetit të Kuvendit të jetë shembull edhe për institucionet tjera. I kemi ndarë mjetet për të blerë kombibuset, pyeti pse nuk është blerë ai automjet kur dihet se kombibuset aktual janë amortizuar?

**Ismet Krasniqi** duke parë problemet me vozitës, së bashku me Kryesinë e Kuvendit është vendosur që të blihen tre vetura dhe ato të shfrytëzohen nga pesë kryetar për një veturë. Njoftoi se janë blerë dy kombibus, por për shkak të mashtrimeve të destinimit të tyre për mallra, ata janë kthyer mbropa, tani jemi në tender për blerjet e tyre.

**Armend Zemaj** vlerësoi përgatitjen e raportit dhe përgëzoi për këtë. Megjithatë do të duhej të përmisoheshin kushtet për gjithë deputetët njësoj, krijimi i zyreve dhe kushteve për punë. Sugjeroi administratën që për shpenzimet kapitale të kërkojnë ndihmën dhe bashkëpunimin e komisionit, që përmes Kryesisë, të ndikojë në realizimin e projeksioneve të Kuvendit.

**Mufera Sinik** nuk kam vërejtje për raportin, është përgatitur mirë. Veturat që iu janë ndarë shëfave të grupeve parlamentare, po i përdorim edhe ne si deputet dhe me këtë rast i falënderohem sekretarit dhe udhëheqësit të transportit që na ka siguruar veturat për transport, edhe pse nuk janë sa duhet stabile.

**Kosara Nikolic** vlerësoi raportin e Kuvendit të kompletuar i cili duhet të jetë shembull për organizatat tjera buxhetore dhe i njëjti është i kuptueshëm dhe transparent. Bëri një vërejtje për shoferët që janë në listë e pagave dhe nuk punojnë, këto vende duhet të plotësuar dhe njëkohësisht të plotësohet numri i veturave dhe shoferëve për nevoja të Kuvendit.

**Besa Gaxherri** është e njohur se deputetët nuk kanë kushte, por jo të gjithë. Ekzistojnë ndarje të mëdha të deputetëve, nuk kemi zyre dhe stafi për punë, prandaj do të ishte mirë që në këtë pikë të ishte i pranishëm Kryetari i Kuvendit për të diskutuar për këto çështje. Është dashur si komision të japim pëlqimin për blerjen e veturave. Kryesia për çështjet buxhetore nuk duhet marrë vendim pa marrë pëlqimin dhe rekomandimet e komisionit.

**Kryesuesi** nuk janë të privilegjuar kryetarët e komisioneve. Nuk ka vendim për blerje të veturave, për ato ka vendosur komisioni gjatë shqyrtimit të buxhetit dhe ato janë në shërbim për komisioneve dhe jo vetëm të kryetarit. Ndërsa për deputetët që udhëtojnë marrin kompenzime.

**Safete Hadërgjonaj** theksoi se janë shpenzuar 235.000€ për blerjen e një veture dhe ajo nuk është blerë, pyeti qfarë ka bërë Kuvendi për të zgjidhur këtë problem, a janë kthyer mjetet?

**Ismet Krasniqi** problemi i ndryshimi të blerjes së veturave është vendosur në rishikim të buxhetit, ku komisioni e ka dhënë pëlqimin e vet. Sa i përket rastit të veturës së porositur legjislaturën e kaluar, njoftoi se lënda është në gjykatë. Gjykata e ka shpallur në vendimin në favor tonin duke na njohur si palë kontraktuese. Ndërkaq për rastin e padisë për kompaninë që nuk i ka kryer punët e porositura në projektin “Villa Gërmija”, gjykata na ka kthyer lëndën mbropa me arsyetimin se nuk mund të jemi palë kontraktuese. Kemi të bëjmë me dy vendime të kundërta. Sa i përket çështjes së sigurimit të zyreve për deputetë, njoftoi se aneksi i shfrytëzuar nga ministritë është liruar dhe tani jemi në fazën e projektit ideor në renovimin e zyreve për nevoja të deputetë. Në vazhdim kërkoi nga komisioni, që ndër të tjera ti drejtohet Kryesisë së Kuvendit edhe me dy rekomandime: Kryesia e Kuvendit të rishqyrtojë vendimin e Kuvendit të Kosovës dt.17.07.2006 lidhur me projektin kapital “ Qendra

administrativo Protokollare - Gërmija”, dhe të njëjtin ta procedojë për seancë plenare, dhe rekomandimi tjetër që në planifikimet afatmesme buxhetore për vitin 2011-2013 në kuadër të Buxhetit të Kuvendit, të krijohet programi i ri “stafi mbështetës politik”.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

- I. Raporti i shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2009 i plotëson kushtet ligjore dhe standartet e kontabilitetit për raportim.

### **7. Shqyrtimi i propozim-amendamentit të grupit punues të Komisionit për Buxhet e Financa për Projektligjin për Financimin e Subjekteve Politike**

**Kryesuesi** njoftoi për punën që ka bërë grupi punues në propozimin e amendamenteve dhe më pas në mënyrë të përgjithshme arsyetoi ndryshimet e propozuara.

**Xhevdet Neziraj** theksoi se ka dy vërejtje në nenin 9 dhe 10, që kanë të bëjë me financimin e aktiviteteve të rregullta politike. Do të duhej të jetë në bazë të numrit të ulëseve në Kuvend dhe jo në bazë të vendeve të fituara sepse kjo bie në kundërshtim me Kushtetutën, që garanton vendet e rezervuara. Te kuvendet komunale mund të mbetet në bazë të vendeve të fituara. Përndryshe ky propozim-ndryshim do të ndalet në Komisionin për Komunitete.

**Armend Zemaj** duke u ndërlidhur me parafolësin, theksoi se me shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, qdo mandat konsiderohet vend i fituar, pavarësisht se a është i rezervuar dhe kjo nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën. Nuk ka parametër tjetër më të mirë që matë fuqinë politike të subjektit politik, përpos votës.

**Safete Hadërgjonaj** sa i përket propozimin për ndarjen e mjeteve prej 10% për subjektet politike që regjistrohen dhe certifikohen për herë të parë, theksoi se krijimi i një mundësie të këtillë ligjore mos po ndikon që kjo qeshtje të shëndrrohet në biznes dhe përfitim personal.

**Kosara Nikolic** unë jam pjesë e grupi punës i cili ka përgatitur propozim amendamentet dhe në takimet e këtij grupit kam dhënë mendimin tim për amendamenti 9.2. dhe 10.2.1.1 lidhur me nivelin qendror. Ky problem ka të bëjë me partitë e mëdha politike kur një deputet kalon prej një subjekti në të tjetrin dhe mjetet financiare duhet të mbesin në partinë në të cilën është zgjedhur si deputet. Për partitë e vogla si psh. në rastin e partisë së SLS-së e cila ka pesë deputetë, ndërsa mjetet buxhetore janë ndarë vetëm për tre deputet. Nëse sistemi zgjedhor ku deputeti është pronar e mandatit të tij kjo mund të ndodh. Kjo është kontradiktore dhe unë nuk votoj për këtë.

**Besa Gaxherri** vlerësoi punë të mirë këto ndryshime që ka propozuar grupi i punës. Risi dhe stimulim për subjektet që certifikohen për herë të parë. Mbështes rregullimin ligjor për mosbartjen e mjeteve të deputetit që ndërron subjektin politik apo bëhet kandidatë i pavarur. Me ligjin për zgjedhjet është dashur të rregullohet që personi që kandidon në një subjekt politik dhe zgjidhet deputetë, do të duhej që ushtrojë mandatin në kuadër të atij subjekti politik deri në fund të mandatit. Në propozim amendamentin 11 ku thuhet se ndërmarrjet publike nuk mund ti përkrahin financiarisht subjektet politike, do të duhej që definimi të jetë më i gjërë, të thuhet nuk mund ti përkrahin financiarisht dhe në asnjë formë tjetër të shërbimeve.

**Armend Zemaj** duke u ndërlidhur me parafolësen, theksoi nëse thuhet se ndërmarrjet publike nuk mund ti përkrahin financiarisht subjektet politike, kjo përfshin të gjitha shërbimet që kanë kosto financiare dhe qdo formë të përkrahjes financiare. Edhe donacioni është i ndaluar.

**Mufera Sinik** njoftoi se deputeti Mahir Yagcilar ka propozuar dy amendamente, e që po shifet se janë marrë parasysh nga grupi punues. Pyeti a ka dallim në mes vendeve të ndara dhe të fituara?

**Kryesuesi** me rastin e kalimit të një deputetit në një subjekt tjetër, grupi punues ka paraparë që mjetet ti mbeten subjektit dhe jo që deputeti ti bartë ato. Sa i përket çështjes së ngritur për fondin për subjektet e reja të certifikuara, theksoi se nuk mund të shëndrrohet në biznes çështja e regjistrimit të subjekteve politike, pasi që shuma që iu takon me rastin e certifikimit nuk do të jetë e madhe. Në çështjet e ngritura për pamundësinë e financimit të subjekteve politike nga ndërmarrjet publike, thekoi se ne po flasim për projektligjin për financimin e subjekteve politike dhe se mënyrat tjerra rregullohen me ligjin për zgjedhjet.

Pas diskutimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

- I. Miratohen propozim-amendamentit të grupit punues të Komisionit për Buxhet e Financa për Projektligjin për Financimin e Subjekteve Politike. Projektligji me amendamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurë të mëtutjeshme.

### **8. Të ndryshme.**

**Kryesuesi** njoftoi anëtarët se vizita e ardhshme e komisionit, organizuar nga Projekti holandez në bashkëpunim me KIPRED, është planifikuar të jetë prej 19-22 maj 2010 në Slloveni.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

#### **Përgatiti:**

Njësia për mbështetjen e Komisionit

#### **Kryesuesi i Komisionit**

Gani Koci

---